



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”**

SHPLLJE KËRKESË PËR DONACION

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullit, të cilit i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas ligjeve në fuqi, i cili ka në fokus të aktivitetit të tij mbrojtjen e jetës, shëndetit fizik dhe mendor të pacientit dhe lehtësimin e vuajtjeve të tij, duke i ofruar një shërbim shëndetësor sa më cilësor dhe dinjitoz.

Me anë të kësaj kërkesë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” si institucioni më i madh shëndetësor në vend, paraqet respektimisht nevojën për mbështetjen tuaj në formë donacioni për një pajisje fotokopje multifunksionale, e cila do të përdoret për lehtësimin e punës administrative në sektorët klinikë dhe shërbimet mbështetëse.

Duke pasur parasysh volumin e lartë të dokumentacionit dhe rëndësinë e përditshme të këtyre pajisjeve në procesin diagnostik dhe trajtues, një mbështetje e tillë do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e cilësisë së shërbimit për qytetarët si dhe në eficiencën e stafit mjekësor dhe administrativ.

Me anë të kësaj thirrje, QSUNT dëshiron të kërkojë vëmendjen e publikut lidhur me mundësinë për të kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe ofrimin e ndihmës në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të hospitalizuar në QSUNT.

Ju falenderojmë paraprakisht për konsideratën tuaj dhe shpresojmë në bashkëpunim të mëtjetshëm.

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”